



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 14 shtator 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Adem Hajdaraj, Kolë Berisha, Armend Zemaj, Selviqe Halimi, Mufera Sinik dhe Vladimir Todorovic.

Munguan: Ibrahim Makolli dhe Ramadan Gashi.

Të pranishëm: Lumnije Murati - ZPRK, Besnik Mehmeti - ZKRK, Rrezarta Ahmeti – KDI, Rashit Gashi - NDI dhe Visar Krasniqi – nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni - kryetar i Komisionit

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 shtatorit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Irena Ahmedit lidhur me çështjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – I përshëndeti të pranishmit dhe ata që e mbikëqyrnin punën e Komisionit. Propozoi të fillohet me rendin e ditës.

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 shtatorit 2009

Procesverbali u miratua me vërejtjen e Adem Hajdarajt, anëtar i Nënkomisionit të Projektligjit për deklarimin e prejardhjes dhe për kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, jo i Nënkomisionit të Projektligjit kundër korrupsionit, anëtare e të cilit është Selville Halimi.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës

Armend Zemaj – Propozoi të formohet një nënkomision. Për kryesues e propozoi Bahri Hysenin - kryetar i Komisionit.

Kryetari - Kërkoi nga anëtarët e Komisionit t'i propozojnë anëtarët e grupit. I propozoi Adem Salihaj, Armend Zemaj dhe Vladimir Todorovic të jenë anëtarë të nënkomisionit.

Meqenëse nuk pati vërejtje për propozimet, ishte konstatim i përgjithshëm të formohet një nënkomision me këtë përbërje: Bahri Hyseni - kryesues i nënkomisionit, Adem Salihaj, Armend Zemaj dhe Vladimir Todorovic - anëtarë. Nënkomisioni do të takohet më 15 shtator 2009, në orën 09:00, në njërin nga sallat e Kuvendit.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Irena Ahmedit lidhur me çështjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryetari - I njoftoi anëtarët me kërkesën e Irena Ahmedit. Si komision nuk kemi autoritet ta shqyrtojmë atë, sepse i është drejtuar kryetarit të Kuvendit.

Adem Salihaj – Tha se Komisioni është rekomandues, nuk merr vendime, sepse vendime merr Kuvendi.

Bajram Kosumi – Kërkesa e Irena Ahmedit i është drejtuar kryetarit të Kuvendit. Kryesia është dashur ta shqyrtonte, por nëse ajo e kërkon këtë nga Komisioni, mund ta japim mendimin tonë.

Adem Salihaj - Tha se kërkesa i është drejtuar kryetarit të Kuvendit dhe jo Komisionit. Kryesia me shkresë përcjellëse mund të kërkonte nga Komisioni komente dhe sqarime për kërkesën e saj.

5. Të ndryshme

Kryetari, i njoftoi anëtarët se Ligji për hetim parlamentar ishte në përfundim e sipër. Pyeti a ishin të mendimit ta procedonin në lexim të parë.

Adem Salihaj - Propozoi që Projektligji për hetim parlamentar të shqyrtohet edhe një herë në Komision, sepse ka nevojë për plotësime.

Ishte konstatim i përgjithshëm që Projektligjin për hetim parlamentar Komisioni ta shqyrtojë edhe një herë në një nga mbledhjet e radhës. Nga administrata kërkoi që Projektligji të dërgohet për deklaram financiar.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni